



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.975/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi - kryetar i kolegjit, Faton Ademi dhe Mehmet Ndrecaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit: A.H. nga Podujeva, rr. “...”, kundër të paditurës: Komuna e Podujevës - Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar F.R., sipas autorizimit, për kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellje në pension, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, C.nr.202/2019, i datës 25.11.2019, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 07.09.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Komuna e Podujevës - Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Podujevë, C.nr.202/2019, i datës 25.11.2019, në pikën I, II, III dhe IV, të dispozitivit, VËRTETOHET.

II. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën V, në pjesën refuzuese të kërkesëpadiisë dhe pikën VI, sa i përket refuzimit të kërkesës që ka të bëjë me llogaritjen e kamatës.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.202/2019, i datës 25.11.2019, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Apropohet pjesërisht kërkesëpadiia e paditësit A.H. nga Podujeva, rr. “...”, si e bazuar. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura Komuna e Podujevës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit A.H. nga Podujeva, rr. “...” tia kompensoj shumën e përgjithshme prej 2,197.08 €, në emër të 3 pagave për përcjellje në pension, paga në vlerën e 3 pagave mesatare të fundit para daljes në pension nga $490.33 \text{ €} \times 3 \text{ paga} = 1,470.99 \text{ €}$ dhe një pagë e gjysmë për shpërbllim jubilar (apo për 40 vjet përvojë pune) në vlerë të 150 % të një page bazë dhe pagën e ka në shumën prej $484,06 \text{ €} \times 1.5 = 726.09 \text{ €}$. Shumën e aprovuar e paditura detyrohet ta paguaj paditësit me kamatë prej 8 %, duke ju llogaritur nga dita e nxjerrjes së këtij

aktgjykimi e deri në pagesën përfundimtare. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të: Obligohet e paditura që t'ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurës në shumën prej 30 €. Në pikën IV, të dispozitivit ka vendosur që: shumën për kompensimin e pagave dhe shpenzimet e procedurës e paditura detyrohet t'ia paguaj paditësit në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit. Në pikën V, të dispozitivit ka vendosur që: përtej shumës së aprovuar për paditësin prej 2,197.08 € shuma tjetër e kërkuar për 2 paga tjera dhe 25 % të 1 page për shpërblimin jubilar prej 1.069 €, i refuzohet si e pabazuar. Në pikën VI, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit të cilën e kërkoj që kamata ti llogaritet nga data 01.09.2017 e tutje deri në pagesën definitive.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e kontestuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, me datën 16.04.2019, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e të ardhurave, të precizuar si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 22.11.2019, me të cilën ka theksuar se: mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj të njëjtën si të bazuar për shumën e kërkuar në padi për tri paga për përcjellje në pension në shumën prej 1,470.99 € me pagë bazë prej 484.06 € sipas kontratës (3x490=1470.99 €) dhe për 3 paga për shpërblim jubilar plus 75 % të një page tjetër shuma prej 3 x 490 + 375 për 75 % të pagës = 1,795 € e që gjithsej i ka kërkuar 3,697.99 €, me kamatë ligjore prej datës 01.09.2017 e tutje.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.202/2019, i datës 25.11.2019, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: nuk është kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse fakti se paditësi ka punuar te e paditura deri në shkuarjen në pension sipas fuqisë ligjore mbushjes së moshës 65 vjeçare për 44 vite përvojë pune. Nuk është kontestues fakti se paditësi ka dal në pension në Gusht të vitit 2017. Kontestuese ishte pjesërisht baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit nga ana e të paditurës tek kërkesa për 3 paga dhe 75 % të një page për shpërblim jubilar kur pretendon paditësi se i takojnë deri sa e paditura e kundërshton këtë fakt sepse paditësit sipas kontratës kolektive të arsimit parauniversitar datës 18.04.2017 i takon vetëm 150 % e pagës bazë apo 1.5 (një pagesë e gjysmë) e saj e jo siç kërkon paditësi. Gjykata pas vlerësimit të provave, thënieve në padi dhe përgjigje në padi si dhe deklarimit të palëve ndërgjyqëse në shqyrtimin kryesor të datës 22.11.2019 ka gjetur se kërkesëpadia e

paditësit është pjesërisht e bazuar dhe si të tillë e ka aprovuar siç është cekur edhe në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit pjesërisht si të bazuar dhe atë për 3 paga për përcjellje në pension duke vërtetuar se ajo kërkesë është e bazuar dhe të njëjtën nuk e ka kundërshtuar as e paditura duke i aprovuar shumën prej 1,470.99 € sepse paditësi 3 muaj para daljes në pension ka realizuar pagë në shumën prej 490.33 € x 3 paga shumën prej 1,470.99 €. Por gjykata nuk e ka aprovuar kërkesën tjetër në tërësi për paga për shpërblim jubilar që ka kërkuar 3 paga nga 490 € dhe 75 % të një page në shumën prej 1.795 €, sepse kjo kërkesë nuk ka mbështetje në kontratë kolektive të datës 18.04.2017. Ka shtuar se paditësit ia ka aprovuar kërkesën prej 726.09 për 1.5 (një pagë e gjysmë) duke marr parasysh se paditësi ka realizuar pagë bazë prej 484.06 € në muaj si dhe një gjysmë page bazë prej 242.03 €, gjithsej për 1.5 për shpërblim jubilar ju ka aprovuar shuma prej 726.09 € dhe shuma e përgjithshme e aprovuar për 3 paga për përcjellje në pension dhe 1.5 (një pagë e gjysmë) apo 150 % të pagës bazë shumën prej 2,197.08 €. Kjo shumë e aprovuar është në pajtim të plotë me Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar të nënshkruar në mes të SBASHK-ut dhe MASHT-it, me 18.04.2017. Kërkesën për 3 paga për përcjellje në pension nuk e ka kundërshtuar as e paditura në shumën prej 1,470.99 €. Është vërtetuar se paditësi para shkuarjes në pension në 3 muajt e fundit ka realizuar pagë mujore prej 490.33 € x 3 paga shuma e aprovuar është 1,470.99 €.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 35 paragraf 8 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit 382 paragraf 2 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 449, 450 dhe 452 paragraf 1 të LPK-së, lidhur me UA 01/17 të KGJK-së për Unifikim të Taksave Gjyqësore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjeshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension me datë 31.08.2017, nuk është kontestues fakti se paditësi ka përvojë pune 44 vite, si mësimdhënës. Nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagave. Gjykata e Apelit nuk u lëshua detajisht me arsyetimin lidhur me gjendjen faktike sepse nuk ka pasur pretendime ankimore në këtë drejtim.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “ Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose

përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes“. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”.

Me nenin 35 paragraf 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: “ Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti ”, ndërsa me paragrafin 9 të po kësaj kontrate, përcaktohet se: “ Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, 9.1. Pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo më larg se 30 ditë nga dita e pensionit ”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të pjesëshëm të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit ti paguaj në vlerë të 150 % të një page bazë dhe tri pagave përcjellëse në pension me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa paditësi ka dalë në pension më datë 31.08.2017, çka do të thotë se kjo marrëveshje - kontratë ka qenë në fuqi në momentin e pensionimit dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës dhe se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 paragraf 1 dhe 2 i LMD-së, me nr. 04/L-077 i datës 30.05.2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pika V, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, dhe pika VI, e dispozitivit sa i përket refuzimit të kërkesës që ka të bëjë me llogaritjen e kamatës, nuk janë shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë dhe pjesën sa i përket llogaritjes së kamatës.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 975/20, me datë 07.09.2020

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi, d.v